



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:072496

Datë: 06.02.2024

Numri i dokumentit: 05288285

P.nr.1116/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ferija Brando, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit G.M., nga fshati, Bashkia Mallakastër, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.2288-10/2018 të datës 09.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren, Merita Kurtishi - Gaka dhe të akuzuarit, me datë 12.08.2022, morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G.M., nga babai dhe nënae lindur, i lindur me datënë Fier, jeton në fshatin, bashkia Mallakastër, Republika e Shqipërisë, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personalshqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë .

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 26.08.2018 rreth orës 16:00, në Prizren, në shëpin e të akuzuarit D.L., , e cila gjendet në rrugën “.....”, në të cilën jeton dhe vepron përkohsisht i akuzuari G.M., me qëllim të friksimit troket në derën e toaletit, në të cilën mbrenda ishte duke u pastruar e dëmtuara Sh.H., , e cila është motra e të akuzuarit D.H., e cila kishte ardhur në vizitë te vëllau, në atë mënyrë që i akuzuari fillimisht troket në derën e toaletit dhe kërkon nga e dëmtuara që të ja hap derën e më pas fillon ta godas me duar dhe shkelma derën, duke tentuar të hyj në toalet me dhunë edhe kundër dëshirës të dëmtuarës me të cilat gjeste dhe veprime të dëmtuarës i ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri personale.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale kanosje nga neni 185 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 38, 39 par.1 pika 1.2, 46 par.1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, 71 72 dhe 185 par.1 të KPRK -së te akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do te ekzekutohet nese i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër te re penale

Obligohet i akuzuari qe të paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësore shumen prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

E dëmtuara Sh.H., nga Vushtria, rr.””, p.nr.,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2288-10/2018 të datës 09.01.2019, kundër të akuzuarve G.M., dhe D.H.; për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së,

Gjykata konstaton që kjo çështje penale fillimisht është evidentuar pranë kësaj gjykate me numër P.nr. 17/2019.

Me aktvendimin e kësaj gjykate P.nr.17/19, të dt. 06.10.2021 është veçuar lënda penale ndaj të akuzuarit G.M., për të cilin është lëshuar urdhërest, ndërsa procedura ka vazhduar ndaj të akuzuarit D.H.,.

Lënda e veçuar si më lartë ka marr numër të ri evidencës dhe ate P.nr.1116/21, kundër të akuzuarit G.M., nga Republika e Shqipërisë, i cili është sjellur në bazë të urdhërarrestit të lëshuar nga kjo gjykatë, P.nr.1116/21 të dt. 13.10.2021, nga ana e zyrtarëve të Stacionit Policor “Alfa “ në Prizren.

Prokurori i shtetit Merita Kurtishi Gaka, në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se qëndron në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit G.M., pasi që kjo aktakuzë është formale dhe mbështetur me ligj, j për çka edhe i njëjti gjatë kësaj seance e ka pranuar fajësin për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, andaj kërkojmë nga gjykata që të njetin ta shpall fajëtor për vepër penale kanosje nga neni 185. Parg. 1 të KPK-së.

I akuzuari G.M., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: unë e kam pranuar për veprën penale e cila më vihe në barrë, andaj propozoi gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, të ket parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike;

Me datë 26.08.2018 rreth orës 16:00, në Prizren, në shëpin e të akuzuarit Demush Iseni, e cila gjendet në rrugën “.....”, në të cilën jeton dhe vepron përkohsisht i akuzuari G.M., me qëllim të friksimit troket në derën e toaletit, në të cilën mbrenda ishte duke u pastruar e

dëmtuara Sh.H., e cila është motra e të akuzuarit D.H., e cila kishte ardhur në vizitë te vëllau, në atë mënyrë që i akuzuari fillimisht troket në derën e toaletit dhe kërkon nga e dëmtuara që të ja hap derën e më pas fillon ta godas me duar dhe shkelma derën, duke tentuar të hyj në toalet me dhunë edhe kundër dëshirës të dëmtuarës me të cilat gjeste dhe veprime të dëmtuarës i ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri personale.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Me rastin e marrjes së vendimit të dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte e tij pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 70 të KPRK gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, moshë e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, andaj duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të të njëjtit, gjykata i shqiptoi dënimin me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) vitinuk kryen vepër të re penale, sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më i kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPPK -së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1161/2021 me datë 12.08.2022

Procesmbajtësja
Ferija Brando

Gjyqtari
Luan Berisha

Numri i lëndës: 2019:072496
Datë: 06.02.2024
Numri i dokumentit: 05288285

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.